STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 1 tetor 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON $12 MILIONE PER NDIHMEN PER KATASTROFEN NGA SUPER STUHIA SENDI (SANDY) PER PASURITE HISTORIKE

Kërkesat priten deri më 25 nëntor nga organizatat jo-fitimprurëse dhe bashkitë

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot $12 milionë në financime federale për organizatat jo-fitimprurëse dhe bashkitë për të mbuluar koston e riparimeve të vendeve të ruajtura historike që pësuan dëm gjatë super stuhisë Sendi (Sandy).

Programi financohet nga Shërbimi i Parkut Kombëtar dhe administrohet nga Trusti i Trashëgimisë Natyrore në partneritet me Zyrën e Shtetit të Nju Jorkut (New York State) të Parqeve, Rifreskimit dhe Ruajtjes Historike.

"Super stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi dëm të rëndë në shumë nga vendet historike të shtetit tonë në komunitete anembanë Nju Jorkut (New York)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Ky financim do të lejojë organizatat jo-fitimprurëse dhe bashkitë që të mbulojnë kostot e riparimeve urgjente pas stuhisë dhe të ndihmojë në rehabilitimin e këtyre vendeve historike."

"Pasuri të panumurta të renditura ose që kualifikohen për renditje në Rregjistrin Kombëtar të Vendeve Historike ishin në rrugën e stuhisë," tha Komisionerja e Zyrës së Parqeve, Rifreskimit dhe Ruajtjes Historike Rouz Harvi (Rose Harvey). "Nën udhëheqjen e Guvernatorit, jemi të ngazëllyer që ofrojmë këtë ndihmë në rimëkëmbjen në vazhdim të Nju Jorkut (New York) nga stuhia."

Pasuritë që kualifikohen për financime duhet të jenë në qarqet Safolk (Suffolk), Naso (Nassau), Kings (Kings), Kuins (Queens), Bronks (Bronx), Nju Jork (New York), Riçmond (Richmond), Uestçestër (Westchester), Roklënd (Rockland), Putnëm (Putnam), Oranzh (Orange), Sallivën (Sullivan) ose Ulstër (Ulster) dhe të jenë të renditura ose të kualifikuara për renditje në Rregjistrin Kombëtar të Vendeve Historike që një burim kontribues Brenda një qarku historiK të renditur ose të kualifikuar për renditje.

Puna duhet të përmbushë Standartet për Trajtimin e Pasurive Historike të Sekretarit të Brendshëm dhe

të miratohet paraprakisht nga Zyra Shtetërore e Ruajtjes Historike. Veprimtaritë që kualifikohen përfshijnë:

- Veprimtaritë e zhvillimit paraprak, përfshirë Raporte të Strukturës Historike, vlerësime të kushteve, plane dhe specifikime dhe sondazhe e studime të tjera që kanë lidhje;
- Stabilizimi arkeologjik;
- Restaurimi i ndërtimit, riparimi dhe stabilizimi; ose
- Restaurimi, riparimi ruajtja dhe stabilizimi i një peisazhi historik të dokumentuar.

Afati përfundimtar për kërkesat është 25 nëntori 2013. Informacion mbi kërkesën, udhëzimet dhe informacion shtesë mbi kërkesat për t'u kualifikuar janë të disponueshme në http://nysparks.com/shpo/. Për pyetje, kontaktoni Zyrën Shtetërore të Ruajtjes Historike në (518) 237-8643.

Në ndryshim nga financimet e tjera shtetërore të ruajtjes historike, asnjë shumë përkuese nuk kërkohet nga aplikuesi, megjithëse injurajohet për fonde përkuese. Kërkesa minimale e financimit për kosto të zhvillimit paraprak është $10,000. Kërkesa minimale e financimit për kosto të kapitalit është $25,000. Sasia maksimale e financimit është $1 milion. Ashtu si me financimet e tjera shtetërore të ruajtjes historike, programi është vetëm rimbursim; projektet duhet të përfundohen brenda 18 muajsh nga dhënia e financimit.

Zyra e Ruajtjes Historike e Shtetit të Nju Jorkut (New York State) (SHPO), pjesë e Zyrës së Parqeve, Rifresikimit dhe Ruajtjes Historike, administron të gjitha programet shtetërore dhe federale të ruajtjes historike që ndihmojnë komunitetet, bashkitë dhe individët që të identifikojnë, vlerësojnë, ruajnë, mbrojnë dhe rigjallërojnë burimet historike, arkeologjike dhe kulturore të tyre.

Trusti i Trashëgimisë Natyrore (NHT) është një korporatë e përfitimit publiK e Shtetit të Nju Jorkut (State of New York). Ajo merr dhe administon financime, dhurata dhe Kontribute publike dhe private për të çuar më tej programet publike në mbështetje të parqeve, mbrojtjes dhe ruajtjes historike anembanë shtetit. Komisioneri i OPRHP-së është gjithashtu Nëpunësi i Ruajtjes Historike Shtetërore dhe kryetari i Bordit të Drejtorëve të NHT-së. SHPO dhe NHT ndajnë synimet dhe qëllimet e përbashkëta të shumë misioneve dhe janë duke krijuar një partneritet për të administruar programin e financimit.